



**AUTORITETI SHETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR**

Nr. 544 prot. Tiranë, më 19.11 2025



UNIVERSITETI POLIS

Nr. 1253 prot. Tiranë, më 20.11 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

AUTORITETIT SHETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

dhe

UNIVERSITETIT POLIS

Sot, me datë 19/11/2025 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

AUTORITETI SHETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR (ASIG), institucion publik qendror, me adresë: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nr. 3, Kati i dytë, Tiranë i krijuar me ligjin nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, misioni i të cilit është krijimi i infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, sipas standardeve evropiane të Direktivës 2007/EC “INSPIRE”. ASIG përfaqësohet ligjërisht nga **Drejtori i Përgjithshëm Znj. Vilma Tomço;**

(në vazhdim ASIG)

dhe

UNIVERSITETI POLIS, institucion universitar privat i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, me adresë: Rruga Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar. Universiteti POLIS ka si mision të tij krijimin, zhvillimin dhe përcjelljen e dijes përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor

dhe inovacionit, në përputhje me ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Universiteti POLIS përfaqësohet nga **Zv. Rektori për Kërkimin dhe Ndërkombëtarizimin Dr. Elona Karafili;**

(në vazhdim UP)

Këtu e më poshtë referuar individualisht si “**Pala**” ose bashkërisht si “**Palët**”.

Baza ligjore

Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.


Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj *Marrëveshje* është të rregullojë dhe të institucionalizojë marrëdhënien e bashkëpunimit midis palëve në lidhje me aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta, rritjen e kapaciteteve njerëzore në përputhje me prioritetet e zhvillimit në vend, si dhe kryerjen e ekspertizave kërkimore shkencore, për përdorimin e mundësive që krijon teknologjia në fushën e gjeoinformacionit.

Neni 2 Fusha e Bashkëpunimit

Për përmbushjen e qëllimit të kësaj *Marrëveshjeje*, fushat e bashkëpunimit do të fokusohen në këto veprimtari kryesore:

1. Përcaktimin e projekteve bashkëpunuese me interes për të dyja palët në fushën e gjeoinformacionit.
2. Bashkëpunimin për aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta shkencore ndërkombëtare dhe vendore.
3. Bashkëpunimin për zhvillimin e studimeve të përbashkëta në fushën e kërkimit shkencor.
4. Shkëmbimin e njohurive dhe të dhënat që avancojnë interesin reciprok të palëve në përputhje me procedurat dhe politikat e secilës palë.
5. Shkëmbimin e materialeve dhe rezultateve të punës studimore dhe shkencore të lidhura me aktivitetin e të dy palëve në respekt të parimit të konfidencialitetit dhe mirëbesimit.
6. Shkëmbimin e informacionit gjeohapësinor si dhe të burimeve njerëzore me qëllim përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore.



7. Informimin në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme midis palëve për përmbushjen e angazhimeve në këtë marrëveshje si dhe për zhvillimet në secilin institucion, që paraqesin interes për aktivitetin institucional të palës tjetër.
8. Krijimin e hapësirave institucionale për zhvillimin e trajnimeve sipas nevojave të palëve.
9. Organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta vendore dhe ndërkombëtare.
10. Krijimin e hapësirave për praktika profesionale dhe mësimore të studentëve në fushën e gjeoinformacionit.
11. Komunikimin efektiv ndërmjet tyre për të organizuar projekte me interes për të dyja palët.

Neni 3



Angazhimet dhe të Drejtat e Palëve

1. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, palët angazhohen të identifikojnë dhe të zbatojnë projekte inovative konkrete bashkëpunimi në fushën e gjeoinformacionit.
2. Palët angazhohen të shkëmbejnë ekspertiza dhe mbikqyrje të përbashkëta të veprimtarisë kërkimore shkencore të cilat vijnë si rezultat i këtij bashkëpunimi.
3. Palët do të informojnë për organizimin e aktiviteteve me interes të përbashkët nga ana e tyre ose në bashkëpunim me institucione apo organizata homologe, vendase apo ndërkombëtare.
4. Palët marrin përsipër të angazhohen në lidhje me programin e praktikave mësimore të studentëve duke pranuar njëri-tjetrin si partnerë në fushën e gjeoinformacionit.
5. Palët angazhohen të vënë në dispozicion të njëri-tjetrit dhe të shkëmbejnë në mënyrë reciproke informacionin që disponojnë për qëllime jofitimprurëse, duke marrë masa për mbrojtjen e këtyre të dhënave nga përdorimi i paautorizuar i tyre.

Neni 4

Konfidencialiteti

1. Secila palë e kësaj Marrëveshjeje angazhohet të mos bëjë publike, të mos përhapë dhe të mos komunikojë tek palë të treta asnjë informacion, dokumentacion apo të dhënë të lidhur me veprimtarinë e zhvilluar në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, si dhe çdo informacion tjetër që nuk është i njohur nga publiku në momentin e marrjes së tij ("Informacion Konfidencial"), përveç rasteve kur ekziston miratimi paraprak me shkrim i palës tjetër.
2. Secila palë angazhohet të përdorë Informacionin Konfidencial vetëm për qëllime që lidhen me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe për asnjë qëllim tjetër, personal ose institucional.
3. Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave sensitive dhe personale, si dhe të respektojnë privatësinë e informacionit të shkëmbyer gjatë bashkëpunimit, duke i administruar ato në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionit të klasifikuar.



- 4 Detyrimi i ndërsjellë për konfidencialitetin do të vazhdojë të mbetet në fuqi dhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje sipas parashikimit të nenit 5 të saj, ose për aq kohë sa informacioni nuk është bërë publik në mënyrë të ligjshme.
- 5 Palët bien dakord që të ruajnë dhe të respektojnë integritetin reciprok.

Neni 5

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet pa afat të përcaktuar dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët, duke prodhuar efektet juridike përkatëse prej datës së nënshkrimit.

Neni 6

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve midis Palëve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, apo të ndonjë marrëveshjeje tjetër, ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e saj, do të zgjidhet miqësisht nga palët.

Neni 7

Njoftimet mes Palëve

Çdo njoftim si dhe komunikim midis palëve lidhur me ndryshimet, shtesat apo me plotësimet që mund të lindin me kalimin e kohës për të realizuar këtë marrëveshje bashkëpunimi, do të kryhet në formë shkresore. Për kryerjen e kësaj procedure me efikasitet, palët caktojnë personat e kontaktit që janë përkatësisht:

Për UP:

Person Kontakti: Leonora Haxhiu, Koordinatore e Programit Master Profesional në Planifikim Territori dhe GIS

E-mail: leonora_haxhiu@universitetipolis.edu.al

Për ASIG:



Person Kontakti: Kristaq Qirko, Drejtor i Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Hartografisë

E-mail: Kristaq.Qirko@asig.gov.al

Palët i komunikojnë njëra-tjetrës ndryshimet eventuale të përfaqësuesve.

Neni 8

Dispozita të Përgjithshme



1. Ndryshimet ose shtesat e pjesëshme që do t'i bëhen kësaj kontrate do të jenë të vlefshme vetëm nëse bëhen me miratimin dhe nënshkrimin e të dyja palëve.
2. Kjo marrëveshje është e hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të barabartë ligjore, nga një kopje për secilën palë.

**PËR
AUTORITETIN SHTETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Znj. Vilma Tomço



**PËR
UNIVERSITETIN POLIS**

**ZV. REKTOR
Dr. Elona Karafili**

